



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Thirrje për aksione në komunitet

Të nderuara organizata partnere,

Pandemia COVID-19, me pasoja tashmë të evidentuara socio-ekonomike, po sjell realitete të reja në komunitetet tona. Për t'u siguruar që implikimet ekonomike dhe sociale nuk prekin joproportionalisht gratë dhe nuk shtojnë barrierat ekzistuese të tyre, D4D ju fton të aplikoni me propozime emergjente për aksione në komunitet për të lehtësuar gjendjen e krijuar.

Qëllimi i kësaj thirrje është të ofrimi i hapësirës për të koordinuar dhe dizajnuar aktivitete shtesë për avokim nga organizatat partnere. Përderisa pjesa organizative mbetet në anën e organizatës udhëheqëse të nismës, D4D do të mbulojë pjesën financiare të realizimit të këtyre aktiviteteve, për së paku tri nga iniciativat që do të dalin nga puna e përbashkët.

Aksione të mundshme të cilat do të mbështeten përfshijnë (por nuk janë të limtuara):

- Analiza hulumtuese për situatën e grave në Kosovë gjatë pandemisë (ekonomike dhe sociale)
- Analiza monitoruese për implikimet gjinore të masave për lehtësimin e krizës ekonomike
- Animacione dhe video vetëdijësuese për rëndësinë e ndarjes së përgjegjësive familjare mes burrave dhe grave, përfshirë kujdesin ndaj fëmijëve, dhunën në familje, etj.
- Organizime të emisioneve në televizione dhe radio për tema që kanë të bëjnë me pikët e lartëcekura
- Debate publike apo konferenca përmes platformave online për tema që kanë të bëjnë më pikët e lartëcekura, etj.
- Video ose seri të foto storive nga persona influencues në komunitetet e juaja për të avokuar për temat e lartëcekura.

Afati i aplikimeve është deri më **24 prill 2020**, duke dërguar aplikacionet tuaja në email adresën: grants@d4d-ks.org. Buxheti maksimal i iniciativave duhet të jetë **1200 euro** (përfshirë edhe pagesat për stafin e angazhuar). Të gjitha aksionet duhet të fillojnë më së largu me **1 maj 2020** dhe përfundohen deri më **15 qershor 2020**.

Mirëpresim aplikimet e juaja, dhe jemi në dispozicion për t'u përgjigjur në çdo pyetje apo paqartësi që mund të keni.

Sinqerisht,
Instituti D4D